



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PAKR.nr.86/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti, kryetar i kolegjit, Dr.sc.Driton Muharremi dhe Vaton Durguti, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi, si procesmbajtëse në lëndën penale ndaj të akuzuarit-dënuarit S.T. nga fshati ... – Komuna Frizaj, për shkak të veprave penale në bashkëkryerje vjedhja e rëndë nga neni 253 par.1 nën. par. 1 lidhur me 23 të KPK-së, veprën penale vjedhja e rëndë në vazhdim nga neni 327 par.1 nën.par. 1.1 të KPRK-së, veprën penale në vazhdim vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par.1 nën. par 1 të KPK-së, veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par.1 nën.par 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së, veprën penale vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, veprën penale në vazhdim vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, veprën penale vjedhja e rëndë në vazhdim nga neni 327 par.1 nën.par 1.1 të KPRK-së, veprën penale në vazhdim vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, veprën penale në bashkëkryerje vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nën.par 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 327 par.1 nën.par 1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit-dënuarit-avokait Vehbi Kashtanjeva, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PK.nr.227/2020 të datës 26.01.2021 për rishikim e procedurës penale- bashkimin e dënimeve, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 01.03.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit-dënuarit S.T., av.Vehbi Kashtanjeva , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj PK.nr.227/2020 të datës 26.01.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj me aktgjykimin PK.nr.227/2020 të datës 26.01.2021 ka ndryshuar sa i përket vendimit mbi dënimin aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Ferizaj PK.nr.205/2020 të datës 19.11.2020, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në

bashkëkryrje nga neni 253 par.1 nën.par 1 lidhur me nenin 23 të KPK, veprën penale vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 par.1 nën.par 1.1 të KPRK-së, veprën penale në vazhdim vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par.1 nën.par 1 të KPK-së, veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nën.par 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së, veprën penale vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, veprën penale vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 par.1 nën.par 1.1 të KPRK-së, veprën penale në vazhdim vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i cili është dënuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 5 vite e 7 muaj si dhe dënim me gjobë në shumë prej 2400 euro, aktgjykimi i plotfuqishëm është bërë me 19.11.2020. Gjykata Themelore në Prishtinë – dega në Lipjan, sipas lëndës P.nr.504/17 të dt. 9.12.2019, për shkak të veprës penale në bashkëkryrje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën.par 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 18 muaj si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 eurove i cili është bërë i plotfuqishëm me 3. Janar 2020 si dhe Gjykata Themelore në Prishtinë – dega në Lipjan me aktgjykimin P.nr.486/17 të dt. 12.12.2019, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 7 muaj si dhe dënim me gjobë në shumë prej 600 eurove, ndërsa aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me datën 08.01.2020. Konform nenit 420 par.1 pika 1.1 dhe par. 2 të KPP-së si dhe nenit 80 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KPRK-së e ka gjykuar me dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 7 vite e 4 muaj si dhe dënimin unik me gjobë në shumë prej 4000 euro. Nëse me gjobë unik nuk mund të ekzekutohet, gjykata konform nenit 46 par.3 të KPRK-së dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro i pandehuri do të vuaj një ditë burgim. Në dënimin e shqiptuar pjesët e tjera të aktgjykimeve të formës së prerë të lartëshënuara mbetën të pa ndryshuara.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit-dënuarit S.T. av. Vehbi Kashtanjeva, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që të aprovohet ankesa e tij dhe të gjykuarit të i shqiptohet një dënim unik më i butë ose çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit i Kosovës duke u skjaruar përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtëses së akuzuarit-dënuarit S.T. me shkresën e tij PPA.I.nr.98/21 të datës 23.02.2021 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit-dënuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit e Kosovës pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtëses së akuzuarit-dënuarit S.T. dhe gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit-dënuarit S.T. me ankesë pretendon se me rastin e shqiptimit të dënimit unik me burg dhe me gjobë të gjykuarit S.T. nuk i ka marr parasysh gjykata e shkallës së parë të gjitha rrethanat konkrete dhe personalitetin e tani të gjykuarit, meqë i njëjti është penduar për veprat penale të cilat i ka kryer, ka pasur çdo herë sjellje korrekte dhe është i moshës së re, familjar, ka 4 fëmij të mitur dhe bashkëshortën, mbajtës i vetëm i familjes dhe i gjendjes së varfër ekonomike. Duhët të merret parasysh edhe gjendja e tij shëndetësore e vlerësuar nga Dr. N.M., psikiatër në NJSHB Dubravë e dt. 02.10.2020 i cili ka bërë ekzaminimin mendor ku ka theksuar se vërehen ide delusive depresive të pa vlerës dhe pa shpresës gjendje që lidhet me rrethanat e tij penale dhe sociale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit-dënuarit S.T. nuk janë të bazuara. Sipas kësaj gjykate, Gjykata Themelore në Ferizaj me rastin e shqiptimeve të dënimeve ndaj të akuzuarit – të dënuarit me aktgjykimin PK.nr.227/2020 të datës 26.01.2021 ka vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite dhe 4 (katër) muaj dhe dënimi unik me gjobë në shumë prej 4000 (katërmijë) euro, të shqiptuara ndaj të akuzuarit-dënuarit S.T. nga Gjykata Themelore në Ferizaj janë në pajtim me nenin 420 par.1 nënpar.1.1 lidhur me par. 5 të KPPRK-së dhe nenin 76 par.1 dhe 2 lidhur me dënimet për bashkim të veprave penale.

Pretendimi ankimor i mbrojtësit të akuzuarit-dënuarit se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit unik me burgim të akuzuarit-dënuarit nuk i ka vlerësuar drejtë dënimin dhe se dënimi është i ashpër nuk qëndron. Shuma e dënimeve të veçanta të përcaktuara ndaj të akuzuarit është 7 (shtatë) vite e 8 (tetë) muaj, ndërsa Gjykata Themelore në Ferizaj me aktgjykimin PK.nr.227/20 të datës 26.01.2021 të akuzuarit-dënuarit i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite e 4 (katër) muaj, pra 4 muaj më pak se shumta e dënimeve të veçanta të përcaktuara. Këtë vendim mbi dënimin e aprovon edhe Gjykata e Apelit të Kosovës si të drejtë dhe të ligjshëm.

Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e cekura me lart dhe rrethanat e rastit konkret del se dënimi unik me burgim dhe me gjobë të shqiptuara ndaj të akuzuarit-dënuarit S.T. nga gjykata e shkallës së parë janë dënime të drejta dhe të ligjshme, si dhe në harmoni me peshën e veprave penale të kryera dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit-dënuarit.

Andaj, Gjykata e Apelit e Kosovës i refuzoi si të pabazuara pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit-dënuarit për shqiptimin e një dënimi unik me burgim më të ulët, ngase është e bindur se me dënimin unik me burgim dhe dënimin me gjobë të shqiptuara nga Gjykata Themelore në Ferizaj do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lart, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.86/21 më 01.03.2021

Procesmbajtëse,
Leonita Lajçi

Kryetar i kolegjit- gjyqtari
1. Abdullah Ahmeti_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Vaton Durguti _____